

VENDIM
Nr. 680, datë 28.9.2016

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TEK AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA), TË MJEDISEVE TË NDËRTESES ME EMËRTIMIN “SHTËPIA E USHTARAKËVE”, GJIROKASTËR, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 435, DATË 16.6.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN “EQREM ÇABEJ”, NË GJIROKASTËR, TË PRONËS NR. 600, ME EMËRTIMIN “SHTËPIA E USHTARAKËVE”, GJIROKASTËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tek Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të mjediseve të katit të parë të ndërtesës me emërtimin “Shtëpia e Ushtarakëve”, Gjiro-kastër, me sipërfaqe 412 (katërqind e dymbëdhjetë) m², sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, për t’u përdorur si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë administrative të ADISA-s.

2. Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHITETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Identifikim: Martina Gjerga Peshqipes e Sektor Juridik, Drejtori e Shërbimeve Mbrojtëse dhe Gardiane, Agjencia e Ombudsmanit Shërbimeve Publike te Integruara (AQSDA) Supervizor: Berta Shkaka Agjencia e Ombudsmanit Shërbimeve Publike te Integruara (AQSDA) Agjencia: Koordinator, Departamenti i Inovacionit dhe Menaxhimit, Ministri i Shërbimeve Publike Inovacionit dhe Administrimit Publik Adresa: Drejtoria e Kuvendit, Ministri per Inovacionin dhe Administrimin Publik									
Numri dhe pershkrimi i Prones Administrative									
A 1. Zona Kufiri & Indeksi i Harta 2. Nr. Prones 3. Lloji i Prones 4.									
B Emri i Prones Adresa 5. 6. Sipërfaqja Totale e Prones (m²) 7. Sipërfaqja Totale e Prones (m²) 8. 9. Vendi i Prones Adresa 10. Sipërfaqja Utilizuar dhe Llogaritja (Shprehje e Gjendjes)									
C 11. Funksionet për të cilat përdoret Prona 12. Institucioni i Entit me përgjegjësi administrative 13. Institucioni i Entit me përgjegjësi personale (Statusi juridik i personit) 14. Agjencia e Ombudsmanit Shërbimeve Publike te Integruara (AQSDA) 15. Agjencia e Ombudsmanit Shërbimeve Publike te Integruara (AQSDA) 16. Te dhëna të tjera (Shërbime të veçanta) 17.									
18. Numri i Prones (Kodi i Prones) Indeksi i Prones (Kodi i Prones) me sipërfaqe prej 412 m² bazuar në përpjesëtimin administrativ të Agjencisë dhe Ombudsmanit Shërbimeve Publike te Integruara									